

Фонд за осигурување на депозити
Fondi për sigurimin e depozitave
03-434/1
20.07 20 22 год.
viti
Скопје - Shkup

**PLANI VJETOR I FONDIT TË
SIGURIMIT TË
DEPOZITAVE PËR
VLERËSIMIN E RREZIQEVE
TË KORRUPCIONIT PËR
VITIN 2022**

ул. "11 Октомври" бр.18
1000, Скопје
Република Северна Македонија

тел: 02 32 35 730
факс: 02 32 96 901
info@fodsk.org.mk
www.fodsk.org.mk

Rr. "11 Tetori" nr.18
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut

tel: 02 32 35 730
faks: 02 32 96 901
info@fodsk.org.mk
www.fodsk.org.mk

Në bazë të Konstatimit të mbledhjes së 55-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, pika 45, e mbajtur më datën 28-të qershor të vitit 2022, ndërsa në lidhje me Planin vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupcioni, në pajtim me Raportin për harmonizim GREKO (rrethi i psetë i evaluimit), në lidhje me rekomandimin II ku ishin të obliguar të gjitha institucionet që të sjellin(përpilojë) plan vjetor adekuad për kompetencat e tyre për vlerësim të rreziqeve të korrupcionit për vitin 2022, drejtori i Fondit të Sigurimit të Depozitave solli si vijon:

PLANI VJETOR PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE TË KORRUPCIONIT PËR VITIN 2022

Korrupcioni është sfidë globale me të cilën ballafaqohen të gjitha vendet, pa marr parasysh shkallën e zhvillimit ose rendin e tyre shtetëror. Për atë, të gjitha vendet në mbarë botën vazhdimisht bëjnë përpjekje për ngritjen e vetëdijes për korrupcionin dhe ndikmin e tij subverziv(të dobësimit) ndaj qytetarëve. Korrupcioni jo vetëm që prish procesin e marrjes së vendimeve, por hynë edhe në të gjitha poret e zhvillimit shoqëror. Përkatesisht, segmentet e zhvillimit social, juridik dhe ekonomik të cilat janë të ildhura ndërmjet veti, për atë paraqitja e korrupcionit në njërin segment ndjeshëm ndikon ndaj gjithë të tjerëve.

Autoritetet gjithnjë e më shumë njohin(mësojnë) se korrupcioni është pengesë serioze për qeveisje efektive dhe efikase, rritje dhe stabilitet, si dhe se në mënyrë urgjente janë të nevojshëm hapa të rëndësishëm për parandalimin e kësaj sfide, në nivel lokal dhe global. Për atë qëllim, vendet zhvillojnë ligje, politika, metodologji dhe programe me qëllim që ta shtypin dhe çrrenjosin këtë fenomen nga sistemet e tyre për të siguruar jetë më kualitative për qytetarët e tyre.

Si përgjigje e kësaj sfide, njëkohësisht si rezultat i angazhimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në luftën kundër korrupcionit, Fondi për Sigurimin e Depozitave e zhvilloj këtë program Antikorrupcion, i cila ka për qëllim që t'i lehtësoj hapat dhe angazhimet në luftën kundër korrupcionit, të kontribuoj në çrrenjosjen e tij dhe të ndaloj paraqitjen e mëtejshme të tij, të siguroj zhvillim të papenguar të demokracisë, sundimin e së drejtës dhe integrimin e sukseshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian. Qëllimi është që të siguroj shërbim publik kualitativ, efektiv dhe efikas, tërësisht të liruar nga praktikat korruptive, i cili do të jetë servis i vërtetë për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në mënyrë shtesë në këtë dokument është dhënë një pasqyrë e shkurtër e profilit të Fondit, qëllimet e tij, kompetencat, si dhe qëllimet për të cilat është përgatitur dokumenti. Më tej, dokumenti përbanë analizë të fushave të rrezikshme për korrupsion në suaza të fushëveprimit të punës, e cila gjegjësisht paraqet përshkrim narativ të gjendjes momentale dhe është mjet për identifikimin e sfidave dhe dobësive, si dhe aktivitetet të cilat do t'i ndërmarr Fondi në hap të vendosjes së sistemit efikas të masave të cilat do të mundësojnë parandalim dhe luftë kundër korrupsionit.

Fondi për Sigurimin e Depozitave është institucion financiar i specializuar shtetror i themeluar në pajtim me Ligjin për Fondin e Sigurimit të Depozitave („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.63/2000- teksti bazë) Ndryshimi: („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr. 29/2002, 43/2002, 49/2003, 81/2008, 158/2010, 43/2014 15/2015, 153/2015, 27/2016 dhe 83/2018).

Qëllimi i Fondit për Sigurimin e Depozitave është që të siguroj depozitat e qytetarëve nëpër banka dhe kursimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe dëmshpërblimin e depozitave të siguruara në banka, filiale të bankave të huaja dhe kursimoreve, në të cilën ka ndodhur rasti i rrezikut.

Detyra themelore

Fondi i dëmshpërblen depozitat, por jo më tepër se 30.000 euro në kundërvlerë me denarin të përlogaritura sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për një depozitë në një bankë, filiale të bankës së huaj dhe kursimore në ditën e aktvendimit përfundimtar për marrjen e lejes së bankës, filiales së bankës së huaj ose kursimores në të cilën ka ndodhur gjendja e rrezikut.

Bankat, filiale të bankave të huaja dhe kursimoret të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë anëtare të Fondi. Anëtarimi në Fond është i detyrueshëm.

Me sigurimin e depozitave në banka, filiale të bankave të huaja dhe kursimore Fondi kontribuon në mbajtjen e stabilitetit dhe besimit të publikut në sistemin bankar dhe financiar në vend. Në ditë e anëtarimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Unionin Evropian do të sigurohen edhe depozitat e personave juridik- tregëtar të vegjël.

Mjetet e Fondit formohen nga investimi themelor, pagesa e premive nga anëtarët e Fondit dhe të ardhura nga plasmanet.

Fondit i paguhen premi nga anëtarët e veta me normë vjetore prej 0,25% të depozitave të përgjithshme të personave fizik në secilën bankë, filiale të bankës së huaj

dhe kusimore. Mjetet e paguara në Fond nga ana e bankave, filialeve të bankave të huaja ose kursimoreve në bazë të premive janë të pakëthyeshme.

Instrumentet në të cilat investon Fondi janë:

1) letra me vlerë të lëshuara nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut me afat maturimi deri në dymbëdhjetë muaj prej momentit të blerjes (posedimit) nga ana e Fondit (në tekstin në vijim: letra me vlerë) dhe letra me vlerë hua të lëshuara nga vende të jashtëme, banka qëndrore ose institucione publike financiare ndërkombëtare, të ranguara nga ana e më së paku dy agjensive të pranuar ndërkombëtarisht për vlerësimin e rrezikut kreditor në njërin nga dy kategoritë më të larta, në shumën e depozitave të siguruara të cilat janë në valutë të huaj.

Fondi fillon me dëmshpërblimin e depozitave të siguruara në afat prej 20 ditësh nga dita e aktvendimit përfundimtar të guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anulimin e lejes së themelimit të punës së bankës, filiale së bankës së huaj ose kursimores.

Burimet njerzore

Organet e menaxhimit dhe udhëheqjes së Fondit për Sigurimin e Depozitave janë:

- Këshilli drejtues dhe

- Drejtori

Fondi i Sigurimit të Depozitave ka 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar. Drejtor i Fondit është emruar, Amir Shabani.

Të punësuarit e Fondit paraqesin kuadër të përgatitur profesional me përgatitje të lartë profesionale përgjegjësia, kualifikimet dhe kriteret e zgjedhjes së të cilëve është e definuar me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës dhe Rregulloren për organizim të brendshëm të vendeve të punës.

QËLLIMET E PLANIT VJETOR PËR ANTIKORRUPCION

Ky Plan vjetor është i dizajniar që të veproj në radhë të parë si masë parandaluese që nënkupton zvogëlimin e rreziqeve për korrupcion nëpërmjet forcimit të legjislacionit, forcimit të funksionimit të sistemit institucioneve dhe këthimin e besimit në të, forcimit të vetëdijes dhe përfëshirjen e shoqërisë qytetare dhe publikun në përpjekjet antikorruptive. Plani vjetor është i mbështetur në procese dhe qëllime reale të cilat duhet të rezultojnë me zvogëlim të vazhdueshëm të korrupcionit, ndërsa implementimi i tij do të përcjellë porosi të fuqishme deri tek shoqëria se lufta kundër korrupcionit realizohet.

ANALIZË NË FUSHAT E RREZIKSHËME NGA KORRUPCIONI

Analiza e fushave të rrezikshëme të korrupcionit është hapi i parë në procesin e përgatitjes së Planit vjetor.

Vlerësimi i rreziqeve i identifikon fushat horizontale në vijim ku gjenerohen rreziqet e korrupcionit:

- Ndjekje dhe identifikim i vazhdueshëm i arsyeve, kushteve dhe faktorëve të cilët do të munëdonin korrupcionin;
- Rritjen e integritetit të të punësuarëve;
- Rritjen e efikasitetit të procedurave administrative;
- Respektimi i dispozitave ligjore dhe Kodti të nëpunësive administrativ;
- Rritje e vazhdueshme e ndërgjegjes publike të qytetarëve që të paraqesin korrupcionin;
- Ndjekje e vazhdueshme e mënyrës së realizimit të kontartave për furnizimet publike dhe
- Informim i vazhdueshëm i qytetarëve për punën e Fondit për Sigurimin e Depozitave.

AKTIVITETE PËR PARANDALIMIN E KORRUPCIONIT

Në drejtim të vendosjes së sistemit efikas të masave të cilat do të mundësojnë parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si fokus kryesor i Fondit për Sigurimin e Depozitave do të jenë aktivitetet në vijim:

Ndjekje dhe identifikim i vazhdueshëm i asyve, kushteve dhe faktorëve të cilët do të mundësonin korrupsion

- Secili udhëheqës sektori/njësie është i obliguar që të ndjek sjelljen e punonjësive në sektor/njësi, veçanërisht të ketë kujdes në respektimin e afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve/aktiviteteve për lëndë konkrete, nëse shtyhen veprime të caktuara të cilat duhet të ndërmerren, cilat janë arsyet për një sjellje të tillë, si dhe t'i kenë parasysh informimet të cilat i parashtrojnë qytetarët në lidhje me qasjen e të punësuarëve dhe në rast të konstatimit të mos respektimit/mos ndërmarrjes së veprimeve dhe në kohë të lëshoj informim deri tek drejtori;

Në bazë të informatave të dorëzuara do të analizohet gjendja dhe do të identifikohen kategoritë e vendeve të punës me rrezik më të ulët të korrupsionit;

- Pas identifikimit të të njejtive, do të propozohen masa për zvogëlim, gjegjësisht largimin e formave të ndryshme të rreziqeve të korrupsionit.

Forcimi i integritetit të të punësuarëve

- Çdo i punësuar në punën e tij të veproj në mënyrë të ndërgjegjshme, profesionale, të përgjegjshme, të ndershme, efikase dhe të paanëshme;
- Edukimin e të punësuarëve që në punën e tyre të njohin dhe kundërshtojnë për çdo situatë joligjore, jomorale dhe jo të ndershme;
- Trajnim dhe motivim i të punësuarëve që t'ju përgjigjen sfidave të kësaj lëmie.

Rritja e efikasitetit të procedurave administrative

- Me qëllim të reagimit në kohë dhe realizimit të të drejtave të qytetarëve dhe të drejtave të personave juridik, është i detyrueshm respektimi i procedurave për punë dhe
- Çdo i punësuar është i obliguar të informoj në rast se vlerëson se gjatë punës ndonjë procedurë e caktuar duhet të ndryshohet/ plotësohet në aspekt të përmirësimit të punës me anë të së njejtës.

Respektimi i dispozitave ligjore dhe Kodit të nëpunësive administrativ

- Personi përgjegjës për burimet njerzore është i obliguar në kohë t'i informoj të punësuarit për standardet etike dhe rregullat e sjelljes sipas rregullave të parapara në Kodin e nëpunësive administrativ.

Rritje e vazhdueshme e ndërgjegjies publike të qyteratëve që të paraqesin korrupcion

- Përpunimin e informatave praktike dhe formular për qytetarët si t'i realizojn të drejtat e tyre dhe ta paraqesin çdo dyshim për parregullsi në veprim dhe sjellje për të punësuar konkret, si dhe dyshimin për ekzistimin e mashtrimit ose korrupcionit;
- Rritjen e besimit të qytetarëve për punën e Fondit.

Ndjekje të vazhdueshme në mënyrën e realizimit të procedurave të furnizimeve publike dhe realizimin e kontratave për furnizime publike

- Respektimin dhe zbatimin e procedurave për furnizime publike dhe realizimin e kontratave, dhe rregullave të parapara në Kodin e sjelljes gjatë zbatimit të furnizimeve publike;
- Inspektim dhe kontrollë mbi aplikimin dhe zbatimin e respektimit të procedurave për realizimin e furnizimeve publike;

- Edukimin e të punësuarëve të përfëshirë në procedurat e furnizimeve publike për respektimin e parimeve, siç janë parimet e lirisë për furnizim me shërbime, si dhe parimet për ekonomi, efikasitet dhe konkurrencë paralele ndërmjetë operatorëve ekonomik.

Informim i vazhdueshëm i qytetarëve për punën e Fondit për Sigurimin e Depozitave



- Demonstrim të llogaridhënies dhe mundësimin e transparencës për punën e Fondit për Sigurimin e Depozitave nëpërmjet të publikimit të të gjitha informacioneve të domosdoshme në ueb faqe, siç është Ligji i Fondit të Sigurimit të Depozitave; raporte gjysmëvjetore dhe vjetore për aktivitetin afarist të Fondit; Raporte të revizionit; Planin financiar dhe Plnin për furnizime publike; Rregulloret për politikë investuese; dëmshtëpërblime; sistematizim dhe organizim i brendshëm i venedeve të punës; informacione për pjesëmarrje të Fondit në ngjarje me interes publik, si dhe njoftime për publikun; informime praktike dhe formularë (fletushka) për qytetarët për realizimin e të drejtës në pajtim me Ligjin për qasje të lirë të informacioneve me karakter publik.

SQARIM

Palni vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupcioni për vitin 2022 do të publikohet në ueb faqen e Fondit për Sigurimin e Depozitave.

Drejtori
Amir Shabani



Përgatiti: Gala Kuzmanovski 
Kontrollooi: Mimoza Çajani
Përthim: Antigona Seferi 

ул. "11 Октомври" бр.18
1000, Скопје
Република Северна Македонија

тел: 02 32 35 730
факс: 02 32 96 901
info@fodsk.org.mk
www.fodsk.org.mk

Rr. "11 Tetori" nr.18
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut

tel: 02 32 35 730
faks: 02 32 96 901
info@fodsk.org.mk
www.fodsk.org.mk